



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2849/5 prot.

Datë 30.10.2025

V E N D I M

Nr.1559/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025, me objekt: “Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, me NIPT L62217032L dhe adresë: Rruga Allaman Dervishi, Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës, me adresë: Lagjia nr.8, Rr.A.Goga, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025, me objekt: “Loti 1 – Aparatura per banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

II.2. Në datën 25.09.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 02.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Albadent Group	581,250	lekë	Skualifikuar
2. ALMedical	586,000	lekë	Skualifikuar
3. Fedos	590,000	lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 09.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Njoftim të Fituesit Paraparak” për procedurën e prokurimit objekt -shqyrtimi.

II.5. Referuar raportit të auditit operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK , rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë: *“Nga sa me sipër KVO konstaton se OE Albadent me Nipt: NIPT: L62217032L nuk plotëson kërkesat për kualifikim , te Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike për dy aparatura Termostate dhe Ngjites. KVO nuk e kualifikon OE Albadent me Nipt L62217032L dhe oferte me vlerë 581.250 lekë pa tvsh ose 697.500 lekë me tvsh”.*

II.6. Në datën 14.10.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5938 dhe me nr. 2849/2025 prot, datë 14.10.2025, e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK , ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 733/2 prot., datë 18.03.2025.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.466/38 prot., datë 23.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2849/2 prot., datë 27.10.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.466/37 prot., datë 22.10.2025 lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në Sistemin e ankesave elektronike nga operatorë ekonomikë në cilësinë e subjektit të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albadent Group” SHA, mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së tij, arsye të përdorura vetëm nga njëri prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni, janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Neni 110 e vijues i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe neni 94 pika 1, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkon shprehimisht që ankimuesi, duhet të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër, KPP gjykon, se arsyet e skualifikimit të cilat janë përdorur/ngritur vetëm nga 1 (një) prej 3 (tre) anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, janë një mendim pakice dhe nuk kanë sjellë pasoja që mund të dëmtonin interesat e ankimuesit, në kuptim të nenit 14 pika 11 “Shumica e nevojshme për të marrë vendime”, të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”. Në këto kushte, për sa kohë operatori ekonomik ankimues nuk është dëmtuar nga këto arsye skualifikimi, pasi nuk janë marrë nga shumica e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, pretendimet e tij për kundërshtimin e këtyre arsyeve të skualifikimit, nuk do të merren në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albadent Group” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Nga sa me sipër KVO konstaton se OE Albadent me Nipt: NIPT: L62217032L nuk ploteson kërkesat për kualifikim , te Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike për dy aparatura Termostat dhe Ngjites. KVO nuk e kualifikon OE Albadent me Nipt L62217032L dhe oferte me vlere 581.250 leke pa tvsh ose 697.500 leke me tvsh”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

7. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhen shqipe, të perkthehen në gjuhen shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik Albadent Group” SHPK për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Katalogu_Loti_1_Albadent_Group.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.2.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. *Oferta konsiderohet e vlefshme, edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.2.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
b) *fotografite apo katalogët teknikë; dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga

ana e autoriteteve kontraktorë, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet që për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull, kriter ky, i cili konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e katalogut në sistemin e prokurimit publik, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull, duke i markuar produktet sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Albadent Group” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni konstaton, se nga ana e KVO nuk janë dhënë shpjegime në mënyrë shteruese, lidhur me mospërmbushjen e kriterit të sipërpërmendur nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar raportit të auditit në SPE, si dhe dokumentacionit të të dorëzuar në SPE, në përmbushje të kriterit të kualifikimit të mësipërm Komisioni gjykon se, është në kushte të paqarta dhe në pamundësi për të vlerësuar mbi arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konkretisht në vlerësimin e dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sepse ky i fundit nuk ka dhënë apo evidentuar qartë se cilat prej specifikimeve të kërkuara nuk përmbushen nga ky operator ekonomik, duke e vënë këtë të fundit në një pozitë jo të qartë, konfuze dhe jo të argumentuar për të argumentuar apo kundërshtuar vlerësimin e dhënë për arsyen e skualifikimit, në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, ku secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, katalogët në rastin konkret, në funksion të pikës 7 të kapacitetit teknik të përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor dhe nëse është rasti të evidentojë qartë dhe saktë, se cilat specifikime teknike nuk përmbushen nga ankimuesi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenit 15 pika 1 e ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë

Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 15, pika 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61260-09-12-2025, me objekt: “Loti 1 – Aparatura për banken e gjakut”, me fond limit 775,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.
 2. Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Albadent Group” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

